



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE
JURIDIKE

Nr. 2000 prot.

Tiranë, më 25 . 09 . 2020

U R D H Ë R

Nr. 64 , datë 25 . 09 . 2020

“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE DHE PËR DEKLARIMIN E PASURIVE NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË””

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 8.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe anekseve pjesë përbërëse të saj.
2. Ngarkohen punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



RREGULLORE
PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE SI DHE PËR DEKLARIMIN E PASURIVE, TE
DETYRIMEVE FINANCIARE,
NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike si dhe për deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” bazohet në nenin 46 të Ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në nenin 204, pika 1, gërma c, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Kodin e Procedurave Administrative (KPrA); Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9131, datë 8.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, në Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (këtu e në vijim “ILD-së”)

Neni 3
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësi dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese në rastet e konfliktit të interesave.

Neni 4
Përkufizime

1. “Zyrtar” është çdo person që ushtron një funksion publik, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas rastit, inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, këshilltarët ligjor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm, Ndihmësinspektorët dhe Drejtori i Drejtësisë.

2. “Epror i një zyrtari” është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar, ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

3. “Person i lidhur me një zyrtar” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me zyrtarin, sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

4. “Parim i proporcionalitetit”, sipas pikës 12 të nenit 3 dhe të nenit 46 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

Neni 5

Fusha e zbatimit

1. Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga:
 - a. çdo zyrtar i ILD-së që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 115/2016, në ligjin 96/2016, në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar;
 - b. çdo zyrtar tjetër i ILD-së, i cili ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në një vendimmarrje, duke përfshirë çastet paraprake dhe çastin e fundit të procesit vendimmarrës;
 - c. çdo person i lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar, si dhe në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm, Ndihmësinspektorët, Drejtori i Drejtorisë, Këshilltari, dhe çdo zyrtar tjetër i ILD-së mbart detyrimin për të garantuar paanësinë, duke deklaruar dhe shmangur çdo situatë konflikti interesi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

Neni 6

Çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a. vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b. vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas germës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
 - i. hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
 - ii. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për

këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;

iii. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;

iv. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;

v. përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative, pa praninë e të cilit nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;

vi. çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i ILD-së ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
 - a. roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b. çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i ILD-së, i emëruar si i tillë me urdhër të posaçëm të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe nga zyrtarët-eprorë në ILD.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9367/2005, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.
5. Në të njëjtat raste, eprori mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.
6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt të interesit të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Neni 8

Interesat private

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit nr. 9367/2005, i

ndryshuar, e konkretisht:

- a. të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b. çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c. dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç. negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- d. angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh. marrëdhënie:
 - i. familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii. të komunitetit;
 - iii. etnike;
 - iv. fetare;
 - v. të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- vi. angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendura në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 115/2016, sipas parimit që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë. Kufizimet e interesave private për parandalimin e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave (rastet e papajtueshmërisë), nuk shterohen vetëm nga ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar.

3. Nëse në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, jo vetëm çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, por dhe kufizimet e interesave private të përcaktuara në ligjet e veçanta mbi të cilat ushtron veprimtarinë ILD, si dhe çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, apo gjendemi para rasteve të papajtueshmërisë së funksionit të parashikuar në ligje të tjera.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PËR RAST TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave

Neni 9

Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i ILD – sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1 e 2 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tyre funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij private, që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit bëhet çdo herë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror.(Aneksi nr. 2).
3. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe duhet bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
4. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt.
5. Njësia e Burimeve Njerëzore, në bazë të vetëdeklarimit të zyrtarit të ILD-së, si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash.

Neni 10

Identifikimi i interesave private të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit për interesat private të zyrtarit në ILD, është:
 - a. detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
 - b. e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi, e që përputhet me qëllimin e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat private të një zyrtari mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Neni 11

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari i ILD-së

1. Autoriteti Përgjegjës vë në dispozicion të zyrtarëve të tij modelin e autorizimit, në formë e në përbajtje, që këta duhet të lëshojnë (Aneksi nr. 1).
2. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të ILD-së, i cili e administron atë gjatë gjithë periudhës që zyrtari është në marrëdhënie pune në institucion.

Neni 12

Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, dhe të kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë, janë:
 - Inspektori i Lartë i Drejtësisë
 - Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë
 - Inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
 - Sekretari i Përgjithshëm;

- Drejtori i Përgjithshëm
 - Drejtori i Drejtorisë;
 - Këshilltarët;
 - Ndhimësinsektorët
3. Autoriteti përgjegjës, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 9367/2005 dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje, ngrihet me Urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
 4. Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e autoritetit përgjegjës në ILD, vendoset si kriter edhe njohja e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoritetit përgjegjës, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Neni 13

Detyrat e autoritetit përgjegjës të ILD-së

1. Autoriteti përgjegjës i ILD-së kryen detyrat sipas udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, me nr.1, datë 27.06.2014, *“Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”*, si dhe çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të ligjeve nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe çdo akti nënligjor të miratuar në zbatim të tyre.
2. Autoriteti përgjegjës i ILD-së veçanërisht kryen këto detyra:
 - a. mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të ILD-së (Aneksi nr. 5);
 - b. shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t’u lëshuar nga zyrtarët e ILD-së, sipas nenit 10 të ligjit nr. 9367/2005 dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje;
 - c. krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit (Aneksi nr. 3);
 - ç. bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të ILD-së, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin:
 - i. e konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - ii. e konfliktit të vazhdueshëm të interesit (Aneksi nr. 6);
 - d. kryen me autorizim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, verifikim dhe hetim administrativ lidhur me interesat privat, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, në të gjitha regjistrat publik apo institucione të tjera duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë eprorin e drejtpërdrejte deri tek titullari i institucionit;
 - dh. në rast të konstatimit të pavlefshmërisë së një akti/kontratë administrative të institucionit publik, sipas përkufizimit të këtij termi në Kodin e Procedurës Administrative, si pasojë e nxjerrjes së tyre në kushtet e konfliktit të interesave(faktik apo në dukje), Autoriteti përgjegjës në bashkëpunim me strukturën përkatëse në zbatim të ligjit nr 9367, datë 07.04.2005 i ndryshuar, kur gjykon se zyrtari ka vepruar në keqbesim:
 - vii. I propozon eprorit/organit kompetent fillimin e procedurave të dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, përgjegjës për pavlefshmërinë e aktit;
 - viii. Propozon të ndërmerren procedurat për kalimin e barrës së dëmshpërblimit te ky zyrtar;
 - ix. Inicion fillimin e procedurave të ankimit pranë organit gjyqësor, për vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;

- x. Propozon të bëhet kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykohet se shkelja e kryer nga ai përbën vepër penale;
- e. përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- ë. merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut me të dhënat personale të zyrtarëve dhe me dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit, duke u bashkërenduar me strukturën përgjegjëse për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
- f. në bashkëpunim me Drejtoritë:
 - i. merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështet Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në ndërmarrjen e hapave ligjorë për dëshmipërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëshmipërblimit te zyrtarët përgjegjës;
 - ii. orienton, vlerëson, kontrollon apo kryen hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të ILD-së, në përputhje me ligjin kuadër, këtë rregullore dhe urdhrat e miratuar nga ILDKPKI-ja;
 - iii. shtron çështje dhe kërkon këshilla nga ILDKPKI-ja për zbatimin e këtij ligji, si dhe për përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
 - iv. merr masa për të miratuar rregulloret e brendshme;
 - g. mbështet zyrtarët e ILD-së në kryerjen e deklaramit periodik të interesave;
 - gj. bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e ILD-së për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së;
 - h. mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të Këshillit për zyrtarët e këtij institucioni;
 - i. ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - j. merr masa për të garantuar informimin e ILDKPKI-së në të gjitha ato raste në të cilat legjislacioni në fuqi apo dhe vendimet e ILD-së parashikojnë informimin e saj.

Neni 14

Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", te ndryshuar, dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Në rast largimi nga detyra, bëhet dorëzimi i gjithë dokumentacionit sipas rregullave të caktuara.
2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës, krijohen dosje të veçanta me përmbajtje si vijon:
 - a) dosja nr.1, me titull "Për aktet ligjore e nënligjore" duhet te permbaje:
 1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
 2. Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike" (i ndryshuar);
 3. Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar);
 4. Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative";

5. Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 6. Ligji nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
 7. Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
 8. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
 9. Komentaret Ligjorë të ILDKPKI-së;
 10. Urdhëra dhe udhëzime të ILDKPKI-së, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;
 11. Botime të tjera të ILDKPKI-së.
- b) dosja nr.2, me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave” duhet të përmbajë:
- Regjistri i regjistrimit të konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
 - Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të interesave;
 - Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
 - Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
 - Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë;
- c) dosja nr.3, me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe të interesave të zyrtarëve, që mbartin detyrim për deklarim në ILDKPKI” duhet të përmbajë:
- Regjistri themeltar alfabetik nr.1, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
 - Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre;
 - Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
 - Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
 - Libri për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.
- ç) libri i regjistrimit të shkresave të nisura dhe të ardhura nga ILDKPKI-ja.

Neni 15

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të ILD-së, krijohet regjistri me të njëjtin emër (Aneksi nr. 3).
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga autoriteti përgjegjës i i ILD-së.

Neni 16

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesave

Autoriteti përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron

identitetin e zyrtarit, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykatat.

Seksioni 2

Identifikimi, regjistrimi, kufizimi i interesave private

Neni 17

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të Këshillit, bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

2. Zyrtarët e ILD-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarime periodike të interesave private, sipas nenit 3 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar janë:

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë
- Zëvendesinspektori i Lartë i Drejtësisë
- Inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- Sekretari i Përgjithshëm;
- Drejtori i Përgjithshëm
- Drejtori i Drejtorisë;
- Këshilltarët;
- Ndihmësinspektorët

3. Në përputhje me nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të ILD-së, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.

4. Çdo zyrtar i ILD-së, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ILD, ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklarim, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar "*Deklaratë Pas Largimit nga Funksioni*".

Neni 18

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e ILD-së, përfiton mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

a. Zyrtari i ILD-së për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, qoftë ky edhe subjekt i ILD-së, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit.

b. Kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i ILD-së, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1, germa b e këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të ILD-së është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a. Kur zyrtari i ILD-së është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve.
- b. Kur vete përjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është i pamundur delegimi i kompetencave të tij te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës.
- c. Kur vendimet e zyrtarit të ILD-së, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një organ epror.
- d. Kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare apo lidhje të tjera).
- e. Kur nuk ka kuptim që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i ILD-së të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni.

Neni 19

Kufizimi i interesave private për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

- Nuk mund te ushtroje asnjë funksion tjetër publik;
Nuk mund te ushtroje asnjë veprimtari tjetër profesionale, që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore;
- Nuk mund te jete anëtar në një parti politike dhe nuk mund te marre pjesë në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike;
- Nuk mund te jete ne asnjë pozicion drejtues ose anëtarësi në organet drejtuese të organizatave fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, me përjashtim të angazhimit në organizata, i cili diktohet për shkak të funksionit;
- Nuk mund te ushtrojë veprimtari private, në kuadrin e subjekteve tregtare, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara me lart.
- Nuk mund te ushtroje asnjë veprimtari tjetër që, sipas ligjit "*Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", është e papajtueshme me detyrën e magjistratit.

2. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë, Inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë te Drejtësisë, Ndihmësinspektorët, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtoriyve dhe Këshilltarët;

- Nuk mund te ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;
Nuk mund te ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër profesionale, që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore;
- Nuk mund te jene anëtar në një parti politike dhe nuk mund te marre pjesë në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike;
- Nuk mund te jene ne asnjë pozicion drejtues ose anëtarësi në organet drejtuese të organizatave fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe

çdo organizatë tjetër, me përjashtim të angazhimit në organizata, i cili diktohet për shkak të funksionit;

- Nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, në kuadrin e subjekteve tregtare, që krijojnë të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara me lart.
- Nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër që, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me ligjin 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe është i papajtueshëm me detyrën e magjistratit/nëpunësit civil.

Neni 20

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në ILD të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në ILD, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

a. “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje, ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 22.10.2004 (VKM nr. 714/2004);

b. Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike të personit që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit

4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 714/2004.

5. Në asnjë rast zyrtari i ILD-së nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 21

Prania dhe kufizimi i interesave private të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e ILD-së, për kufizimet e interesave private të zyrtarëve, të përcaktuara në nenet 18 e 19 të kësaj rregulloreje, janë përkatësisht:
 - a. bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es;
 - b. çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindura nga ky veprim.
2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e ILD-së, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Për sa u përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e ILD-së dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.
4. Personi i lidhur me zyrtarin nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritët me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur.

Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme.

 - a) Mjeti i vetëm, me të cilin ky zyrtar mund të krijojë efektet e mësipërme, është një ligj ose një vendim i këshillit të bashkisë, ose qarkut ose një vendim gjyqësor.
 - b) Veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore që nuk tejkalon kufirin prej 10 milionë lekësh.

Neni 22

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/punonjësit e ILD-së bëhen sipas kreut IV të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Neni 23

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur u jep zyrtarëve të ILD-së të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cenimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 115/2016 dhe në këtë rregullore.
2. Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 115/2016.
3. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, ngarkohen zyrtarët, strukturat përgjegjëse dhe autoriteti përgjegjës i ILD-së, të cilët i përmbahen formatit të miratuar me anekset 1-12, dhe që përbëjnë pjesë integrale dhe të pashkëputur të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Hyrja në fuqi

- 1.Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin e saj
- 2.Kjo rregullore, menjëherë me miratimin e saj, publikohet në faqen zyrtare të internetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.